

Nr. 2654/2 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 04.07 . 2022

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar:

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
(Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1, 1001, Tiranë)

Për dijeni: Komitetit Shqiptar të Helsinkit

(Rr. "Brigada e VIII", Pall TeknoProjekt, Ap. 10, Kati 5, Tiranë)

E nderuar **Znj.**

Në përgjigje të shkresës suaj Nr. 4439/1 Prot, dt. 17.06.2022, me objekt "Mbi kërkesën për informacion për Hec Skavica të Komitetit Shqiptar të Helsinkit", hyrë në KESH sh.a me Nr. 2654/1 Prot, datë 20.06.2022, Ju informojmë si më poshtë:

Pyetja 1: Në cilën fazë të detyrave të parashikuara në Shojcën I të VKM-së është aktualisht zbatimi i kontratës për shërbime teknike?

Në zbatim të parashikimeve të ligjit Nr. 38/2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International, Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës" ("Ligji 38/2021") dhe VKM nr.485, datë 30.7.2021 "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "kontratë për shërbime teknike - projekti Hidroenergjetik i Skavicës" ndërmjet KESH SHA dhe Bechtel Limited", shoqëria Bechtel Limited është duke zhvilluar fazën e parë të projektit për ndërtimin e HEC Skavica.

Aktualisht bazuar në shtojcën e VKM Nr 485/2021 janë duke u zhvilluar dokumentet e pikave Milestones .8 dhe Milestone . 7.

Referuar parashikimit të pikës 2 të nenit 2 të ligjit 38/2021 shoqëria Bechtel është në proces realizimi të veprimtarive të mëposhtme:

- a) matje topografike dhe studime hidrologjike në mbështetje të zhvillimit të projektimit;
- b) studime dhe inspektime gjeoteknike në terren:

- c) zhvillimin e strategjisë për realizimin e projektit;
- d) rishikimin dhe finalizimin e vlerësimit të ndikimit mjedisor e social;
- e) përgatitjen e projektit teknik, përfshirë përzgjedhjen e furnitorit të turbinave, me qëllim preventimin e kostove dhe të sasive; dhe shërbime të tjera të dakordësuara për të mundësuar ecurinë e zhvillimit të projektimit të hidrocentralit të Skavicës. Alternativat për vendndodhjen e digës dhe elementeve të tjera të Projektit;
- f) llojin dhe lartësinë e digës;
- g) korridorin e linjës së transmetimit;
- h) rrugët hyrëse dhe facilitetet e përkohshme;
- i) vlerësimet gjeologjike, gjeoteknike, hidrologjike, të ndryshimit të klimës dhe përmbytjeve;
- j) studimet për fuqinë dhe prodhimin e energjisë;
- k) tunelet për skemën hidrike.

Pyetja 2: *A është realizuar Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) nga ana e ofruesit të shërbimit "Bechtel Limited", dhe nëse po a është konsultuar ky dokument me publikun? KShH kërkon të njihet me dokumentacionin e VNMS-së nëse disponohet në këtë fazë.*

Një studim i veçantë, i quajtur raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) është duke u përgatitur me qëllim identifikimin, reduktimin dhe/ose menaxhimin e duhur të ndikimeve që do të krijojë projekti. Raporti i VNMS është një kërkesë e legjislacionit shqiptar dhe është duke u përgatitur gjithashtu në përputhje me Standardet e Performancës së IFC, të cilat përcaktojnë kërkesa strikte në lidhje me mënyrën se si duhet të menaxhohen risqet dhe ndikimet e Projektit.

Raporti i VNMS është duke u realizuar nga Golder, një kompani me eksperiencë dhe e njohur ndërkombëtarisht si referuar edhe parashikimeve të VKM Nr. 485/2021

Studimi i VNMS do të vlerësojë me kujdes:

- ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të Projektit (si ato negative ashtu edhe ato pozitive);
- mënyrat se si ndikimet negative mund të shmangen, minimizohen dhe/ose korrigjohen qysh në fazat e hershme të hartimit të projektit;
- ndikimet e mundshme në jetesën e komuniteteve të prekura, grupet në nevojë, infrastrukturën sociale, trashëgiminë kulturore si dhe burimet natyrore;
- qasjen dhe parimet e kompensimit dhe zhvendosjes nëpërmjet hartimit të dokumentit të Politikave Kuadër të Zhvendosjes i cili do të orientojë Planin e Veprimit të Zhvendosjes;

Janë kryer tashmë studimet e gjendjes ekzistuese mjedisore për sezonet e verës, vjeshtës dhe dimrit. Pjesa e mbetur e studimeve mjedisore si dhe studimet e gjendjes ekzistuese sociale do të kryhen brenda vitit 2022.

Diskutimet fillestare me palët e interesit si dhe studimet që do të pasojnë do të përfshihen në draft raportin e VNMS. Raporti po ashtu do të përfshijë strategjinë e propozuar për kompensimin dhe zhvendosjen dhe më pas do të ndahet me komunitetet e prekura për të marrë opinionet dhe komentet e tyre. Raporti pritet të jetë gati për opinionet dhe komentet e publikut gjatë tremujorit të tretë të vitit 2022.

Gjatë fazës së hartimit të raportit janë realizuar angazhime të ndryshme në nivel lokal dhe qendror me qëllim grumbullimin e informacioneve të nevojshme. Më tej, me hartimin e draft raportit dhe nxjerrjes së konkluzioneve për projektin, marrja e opinionëve nga palët e interesit dhe publiku i gjerë do të realizohet nëpërmjet dëgjësave të hapura publike ku do të prezantohen ndikimet sociale dhe mjedisore të evidentuara si dhe masat e propozuara për eliminimin, minimizimin dhe trajtimin e tyre. Bazuar në legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, opinionet e marra nga palët e interesit në këto dëgjësia publike do të reflektohen më pas në raportin përfundimtar. Pra, projekti ka gjithë angazhimin e nevojshëm për të realizuar konsultimet me publikun sipas parashikimeve ligjore dhe standardeve ndërkombëtare dhe këto konsultime do të kryhen me përfundimin e studimeve dhe raporteve të nevojshme për t'ju prezantuar publikut. Raportet mbi angazhimet e kryera në të gjitha fazat e projektit, çështjet e diskutuara si dhe opinionet e marra do të jenë po ashtu një pjesë integrale raportit përfundimtar të VNMS.

Pyetja 3: *Në përputhje me parashikimet në Shtojcën 1 lidhur me raportet, evidentohet se subjekti "Bechtel Limited", dorëzon raport-progres mujor mbi konstatimet, shërbimet e kryera sipas rastit duke identifikuar vështirësitë, vonesat, shkaqet dhe zgjidhjet potenciale për mbarëvajtjen e punimeve. A është respektuar nga ana e subjektit të kontraktuar ky detyrim kontraktual KShH kërkon të njihet me kopjen e këtyre raporteve të progresit për të vlerësuar ecurinë e projektit dhe shqetësimet e ankuësues.*

Sqarojmë se faza e parë e projektit Skavica ka si qëllim mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe vlerësimin e të gjithë të dhënave të nevojshme për qëllime të realizimit të projektit të HEC Skavica. Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe përpunuara, do të përgatiten produktet e fazës së parë, të cilat do të miratohen bazuar edhe në parashikimet e nenit 5 të Ligjit Nr. 38/2021.

Theksojmë se, në këtë fazë të projektit të HEC Skavica, nuk ka një vendimmarrje për projektin final të ndërtimit dhe e gjithë veprimtaria e fazës së parë zhvillohet me qëllim arritjen e një vendimmarrje finale të bazuar në të dhëna teknike dhe ekonomike. Pas caktimit të të dhënave bazë të projektit të ndërtimit do të vijojë puna sipas parashikimeve të legjislacionit Shqiptar për menaxhimin e ndikimit mjedisor dhe social.

Aktualisht kontraktori është duke mbledhur të gjithë të dhënat e nevojshme, ndër to edhe ato për vlerësimin e ndikimit social dhe mjedisor për të gjithë opsionet e mundshme të projektit që do të mund të zbatohet për HEC Skavica, këto me qëllim arritjen e përfundimeve të nevojshme për përzgjedhjen e projektit përfundimtar të zbatimit.

Raportet mujore që shoqëria Bechtel dorëzon, kanë të bëjnë me progresin e zbatimit të kontratës, elementeve të saj dhe dorëzimit të produkteve të kontratës pranë KESH sh.a. dhe nuk përmbajnë të dhëna për ankime apo elementë të tjerë, sa kohe në terren realizohen vetëm veprime për mbledhje të dhënash.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.



ADMINISTRATORI